

iSIGURIMET

Nr. #019 • Gusht 2020 • www.shs-ks.com

f # InsuranceAssociationofKosova

Dekada
e zezë!

06



EFEKTI COVID 19:
SIVJET 150 MIJË
POLICA MË PAK

07

REKORD NË PAGESËN E DËMEVE NË KOHË PANDEMIE

Pavarësisht problemeve të shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të paregjistruara të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve kanë arritur të paguajnë më shumë se 21 milionë euro vetëm gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti, apo rreth 50 % të të hyrave totale që ata kanë arritur të inkasojnë gjatë kësaj periudhe kohore. Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, thotë se pagesa e shpejtë e dëmeve është prioritet i secilës kompani që operon në vendin tonë

04

Personal Accident Claim Form

To expedite your claim, please (1) complete this form, (2) present the relevant documents requested in Step 1, and (3) provide the necessary information.

A. POLICY DETAILS

Policyholder/Insured's
Full Name
Office/Mobile No.
Correspondence
Address
GST-registration No.
(if registered)

21,048,461€

DËME JANË PAGUAR
DERI NË FUND TË MUAJIT
QERSHOR TË VITIT 2020

Dekada e zezë!

189 fëmijë të vdekur në aksidente trafiku për 10 vite në Kosovë

Shifra alarmante të vdekjeve të fëmijëve janë publikuar në raportin e fundit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Policisë së Kosovës me titull: Dekada e sigurisë rrugore 2010-2019, ku bëhet e ditur se gjatë dekadës së fundit në aksidente të ndryshme në komunikacion kanë humbur jetën 189 fëmijë.


Sipas këtij raporti, gjatë vitit 2010, 17 fëmijë të moshës 0-12 vjeç kanë humbur jetën në aksidente trafiku, që njëherësh shënon vitin

me numrin më të madh të vdekjeve të fëmijëve. Numri i fëmijëve të vdekur në komunikacion gjatë viteve 2014 dhe 2019 ishte përgjysmë më pak, kur kanë humbur jetën nga 8 fëmijë. Ndërsa gjatë viteve 2010-2019, 72 persona të grup-moshave 13-18 vjeç kanë humbur jetën në aksidente të ndryshme në komunikacion. Më shumë fëmijë të kësaj grup-moshe kanë vdekur në vitin 2017, përkatësisht 11, ndërsa më së paku në vitin 2016, kur kanë vdekur 3 fëmijë të kësaj grup-moshe.

Të vdekur sipas
grup-moshave
0-12 vjeç

**TË VDEKUR
GJATË
VITEVE**

**2010-2019:
117**




Të vdekur sipas grup-moshave **13-18 vjeç**

TË VDEKUR GJATË

VITEVE

2010-2019:

72



Rreth 15 mijë fëmijë u lënduan në aksidente komunikacioni gjatë dekadës së fundit


Në aksidente të ndryshme në komunikacion gjatë dekadës së fundit, përkatësisht gjatë viteve 2010-2019, janë lënduar 14.954 fëmijë. Kjo bëhet e ditur në raportin e fundit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Policisë së Kosovës me titull: Dekada e sigurisë rrugore 2010-2019.

Sipas këtij raporti, gjatë viteve 2010-2019, në aksidente të ndryshme

komunikacioni janë lënduar 8162 fëmijë të moshës 0-12 vjeç. Numri më i madh i fëmijëve të lënduar në komunikacion ka ndodhur në vitin 2016, kur ishin lënduar 1,110 fëmijë të moshës 0-12 vjeç. Ndërsa nga grup-moshat 13-18 vjeç numri më i madh i të lënduarëve në komunikacion ishte shënuar vitin e kaluar (2019), me ç'rast ishin lënduar 877 fëmijë.


Të lënduar sipas grup-moshave **0-12 vjeç**

**TË LËNDUAR GJATË
VITEVE 2010-2019: 8.162**



Të lënduar sipas grup-moshave **13-18 vjeç**

**TË LËNDUAR GJATË
VITEVE 2010-2019: 6.792**



Rekord në pagesën e dëmeve në kohë pandemie

Pavarësisht problemeve të shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të paregjistruara të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve kanë arritur të paguajnë më shumë se 21 milionë euro vetëm gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti, apo rreth 50 % të të hyrave totale që ata kanë arritur të inkasojnë gjatë kësaj periudhe kohore. Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, thotë se pagesa e shpejtë e dëmeve është prioritet i secilës kompani që operon në vendin tonë

ISIGURIME

Më shumë se 21 milionë euro dëme kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë kanë arritur t'i paguajnë vetëm gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti. Pavarësisht problemeve të shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, ku për një kohë të gjatë kompanitë e sigurimeve kanë punuar me orar e staf të reduktuar, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të paregjistruara, e të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve kanë arritur një rekord të pagesës gjatë kohës së pandemisë. Shuma e mjeteve që ato kanë paguar në emër të dëmeve është sa gjysma e mjeteve që ata kanë arritur të inkasojnë gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se deri në fund të muajit qershor 2020 janë paguar gjithsej 21.048,461 euro dëme, derisa gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak të gjitha kompanitë kishin paguar 22.045,342, e gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018 shuma e mjeteve të paguara në emër të dëmeve kishte arritur në 20.834,757.

SHUMË MILIONË U PAGUAN NË KOHË KRIZE

Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës Sami Mazreku thotë se pagesa e shpejtë e dëmeve është prioritet i secilës kompani që

operon në vendin tonë. Sipas tij, në vazhdimësi ka rritje të shumës së mjeteve të cilat janë shpenzuar në emër të kompensimit të dëmeve. "Prioritet i secilës kompani të sigurimit është pagesa e shpejtë dhe korrekte e dëmit. Është shumë me rëndësi të ceket se kompanitë e sigurimeve në Kosovës kanë paguar miliona euro edhe në kohën e pandemisë kur ato thuajse nuk kanë inkasuar prim fare. Shumë milionë u paguan në kohë krize" ka thënë Mazreku. Më tutje Mazreku ka apeluar tek institucionet e Republikës së Kosovës që sa më shpejt që është e mundur të nisin edhe në praktikë punën për zvogëlimin e automjeteve të paregjistruara, ku nga qarkullimi i tyre shteti brenda vitit humb dhjetëra milionë euro. Sipas tij, kompanitë e sigurimeve dëmtohen tej mase sepse duhet të paguajnë dëme për automjetet që shkaktojnë aksidente e që nga to nuk kanë marrë asnjë cent në emër të primit. "Shoqata e Sigurimeve të Kosovës mirëpret iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për trajtimin e automjeteve të paregjistruara në vendin tonë. Shoqata e Sigurimeve, e përkrahur edhe nga guvernatori BQK-së Fehmi Mehmeti, në vazhdimësi e ka ngritur problemin e automjeteve të paregjistruara, të cilat u sjellin dëme të mëdha si kompanive të sigurimit, ashtu edhe institucioneve të Kosovës", ka thënë më tutje drejtori Mazreku.

DËMET E PAGUARA SIVJET

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë qershorit të këtij viti në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve kanë paguar 3,8 milionë euro, ndërsa gjatë muajit maj të këtij viti janë paguar 1,4 milionë euro, në muajin prill janë paguar 3,1 milionë euro, në muajin mars 3,1 milionë euro, në muajin shkurt 4,1 milionë euro, si dhe në muajin janar shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 5,5 milionë euro, apo gati 100 % më e lartë se sa ishte në muajin e njëjtë në vitin paraprak.

GJYSMË MILIARDË EURO DËME TË PAGUARA DERI MË TASH

Bazuar në të dhënat zyrtare të BQK-së të cilat i ka siguruar 'iSIGURIME', shihet se nga viti 2000 e deri më tash kompanitë e sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 500 milionë euro dëme. Duke u mbështetur në këto të dhëna shihet se gjatë 6 muajve të parë të këtij viti





nga kompanitë e sigurimeve janë paguar 21 milionë euro, gjatë vitit 2019 janë paguar 50 milionë euro, gjatë vitit 2018 janë paguar 42,7 milionë euro, gjatë vitit 2017 janë paguar 42,1 milionë euro, gjatë vitit 2016 janë paguar 36,5 milionë euro, gjatë vitit 2015 janë paguar 37 milionë euro, gjatë vitit 2014 janë paguar 31.1 milionë euro. Po ashtu, në vitin 2013 janë paguar 38,4 milionë euro, në vitin 2012 janë paguar 30,5 milionë euro, në vitin 2011 janë paguar 26,8 milionë euro, në vitin 2010 janë paguar 26,5 milionë euro, në vitin 2009 janë paguar 18,8 milionë euro, në vitin 2008 janë paguar 17,7 milionë euro, në vitin 2007 janë paguar 12,8 milionë euro, në vitin 2006 janë paguar 10,9 milionë euro, në vitin 2005 janë paguar 9,1 milionë euro, në vitin 2004 janë paguar 6,7 milionë euro, në vitin 2003 janë paguar 5,5 milionë euro, në vitin 2002 janë paguar 3,5 milionë euro si dhe në vitin 2000 janë paguar 2,6 milionë euro dëme.

VITI	PAGESA E DËMEVE	TË HYRAT TOTALE
2020(1-6)	21.048,461 €	44.661,331 €
2019	49.977,495 €	97.999,080 €
2018	42.766,736 €	90.503,664 €
2017	42.151,078 €	84.919,344 €
2016	36.871,506 €	81.235,523 €
2015	36.971,397 €	78.767,663 €
2014	31.182,207 €	80.080,181 €
2013	38.448,821 €	77.385,883 €
2012	30.581,215 €	81.534,352 €
2011	26.812,984 €	78.095,611 €
2010	26.527,830 €	71.243,658 €
2009	18.834,757 €	67.756,310 €
2008	17.678,577 €	56.380,959 €
2007	12.821,635 €	50.811,083 €
2006	10.932,644 €	34.705,304 €
2005	9.165,533 €	47.212,598 €
2004	6.743,000 €	39.090,000 €
2003	5.583,705 €	37.060,000 €
2002	3.540,000 €	27.231,000 €
2001	/	/
2000	2.655,000	31.161,000 €



Efekti COVID 19: Sivjet 150 mijë polica më pak

Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti të gjitha kompanitë e sigurimeve, duke përfshirë këtu edhe Byronë Kosovare të Sigurimeve, kanë shitur 347.403 polica obligative e vullnetare. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë më pak 147 mijë e 524 polica. Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, alarmon për rritje enorme të numri të automjeteve të peregjistruara të cilat po qarkullojnë nëpër rrugët e Kosovës

iSIGURIME

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve është më i vogël për 147 mijë e 524 polica. Referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë 6 muajve të parë të këtij viti janë shitur gjithsej 347.403 polica sigurimi, ku nga ky numër 172.486 janë polica TPL, 65.567 janë polica kufitare si dhe pjesa tjetër prej 109.350 janë polica vullnetare. Derisa gjatë 6 muajve të parë të vitit 2019 janë shitur 494.927 polica, ku nga ky numër 207.959 janë polica TPL, 120.671 janë polica kufitare deri sa 166.297 janë polica vullnetare. Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, alarmon për rritje enorme të numrit të automjeteve të peregjistruara të cilat po qarkullojnë nëpër rrugët e Kosovës. “Nga viti 2018, por edhe aktualisht, ne kemi kërkuar dhe po kërkojmë përkrahjen Institucionale për të ulur numrin e madh të automjeteve ta peregjistruara të cilat janë duke qarkulluar në vazhdimësi nëpër rrugë. Ngado po dëmtohen qytetet, po dëmtohet shteti, po dëmtohem ne. Është momenti i fundit kur të gjithë së bashku duhet të angazhohemi për ta ulur këtë numër”, ka thënë

drejtori Mazreku.



“NGA VITI 2018, POR EDHE AKTUALISHT, NE KEMI KËRKUAR DHE PO KËRKOJMË PËRKRAHJEN INSTITUCIONALE PËR TË ULUR NUMRIN E MADH TË AUTOMJETEVE TA PAREGJISTRUARA TË CILAT JANË DUKE QARKULLUAR NË VAZHDIMËSI NËPËR RRUGË. NGADO PO DËMTOHEN QYTETET, PO DËMTOHET SHTETI, PO DËMTOHEMI NE. ËSHTË MOMENTI I FUNDIT KUR TË GJITHË SË BASHKU DUHET TË ANGAZHUEMI PËR TA ULUR KËTË NUMËR”, KA THËNË DREJTORI SAMI MAZREKU.

Viti	TPL	Kufitare	Vullnetare	Total
2020	172.486	65.567	109.350	347.403
2019	444.780	424.615	327.446	1,196.841
2018	421.732	391.898	260.092	1,073.722
2017	413.793	384.420	225.156	1,023.369
2016	386.718	362.464	202.357	951.539
2015	350.016	442.031	185.460	977.507
2014	332.350	488.598	177.093	998.041
2013	323.682	437.184	156.665	917.531
2012	278.235	355.407	123.530	757.172
2011	285.900	220.452	98.862	605.214
2010	258.022	192.801	89.916	540.739
2009	253.445	181.290	77.031	511.766
2008	251.541	153.001	71.852	476.394
2007	232.878	143.623	29.842	406.343
2006	251.641	136.182	17.977	405.800
2005	223.770	134.596	14.520	372.886
2004	241.901	120.609	8.423	370.933
2003	199.223	62.073	3.827	265.123
2002	175.008	72.358	/	247.433
2000	/	/	/	179.864

PERIUDHA E KRAHASUAR JANAR-QERSHOR:

Viti	TPL	Kufitare	Vullnetare	Total
2020	172.486	65.567	109.350	347.403
2019	207.959	120.671	166.297	494.927
2018	198.878	113.211	128.331	440.420



Qeveria synon të krijojë fond të veçantë për sigurimin e kulturave bujqësore

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka deklaruar se po punojnë që në programin qeverisës 2020-2023 ta kenë fondin që do të siguronte kulturat bujqësore, derisa ka treguar se nëpërmjet programeve zhvillimore bujqit do të kenë mundësi të përfitojnë nga fondi prej 53 milionë eurosh. Ministri Mustafa për KosovaPress, ka thënë se ky fond do t'i ndihmonte fermerët në Kosovë që t'i realizojnë sigurimet bujqësore.

MUSTAFA: DO TË KETË FOND PËR SIGURIMET BUJQËSORË

“Ne si Ministri e Bujqësisë e kemi pjesë të programit qeverisës 2020-2023 ta themelojmë një fond për sigurimin e kulturave bujqësore, jemi duke punuar intensivisht drejt këtij fondi. Ministria e Bujqësisë deri më tani nuk ka pasur fond të tillë. Aktualisht jemi duke punuar edhe me donatorë, në aspektin ligjor dhe në atë financiar të ndërtojmë një fond të vetëqëndrueshëm, i cili ua ndihmon fermerëve kosovarë që të realizojnë sigurimet bujqësore”, thotë ai. Mustafa ka shtuar se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka shpallur dy programe zhvillimore, duke theksuar se në të përfshihet programi për grante për 18 muaj, për 6 muajt e këtij viti dhe 12 muajt e vitit të ardhshëm, si dhe programi për pagesa të subvencioneve për këtë vit, i cili është 24 milionë euro. Mustafa tha se është ndarë edhe një fond prej 3.1 milionë eurosh për kompensimin e dëmeve dhe nëse nuk është i mjaftueshëm, atëherë do të kërkohet nga Kuvendi i Kosovës që ky fond të rritet.

MUSTAFA: 3.1 MILIONË EURO TË NDARA PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE BUJQËSORË

“Ministria e Bujqësisë para pak javësh ka

shpallur dy programe zhvillimore: programin për zhvillimin rural, siç njihet në gjuhën e përditshme, programin për grante për 18 muaj, për 6 muajt e këtij viti dhe 12 muajt e vitit të ardhshëm, në vlerë mbi 29 milionë euro, dhe programin për pagesat direkte ose pagesat e subvencioneve për sivjet që arrin në 24 milionë euro, pra gjithsej 53 milionë euro. Kemi edhe 3.1 milionë euro të ndara për kompensimin e dëmeve, natyrisht ky është viti i parë që Ministria e Bujqësisë ka një fond të veçantë të ndarë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Do të shohim nëse ky fond do të mjaftojë, nëse jo, do të bëjmë kërkesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ky fond i Ministrisë së Bujqësisë të rritet për të mbuluar një pjesë më të madhe të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore bujqve kosovarë”, thotë ai. Ndërsa kryetari i Sindikatës së Bujqve të Kosovës, Tahir Tahiri, ka thënë se qeveritë e kaluara kanë pasur një marrëveshje me bankat në Kosovë, për sigurimin e kulturave bujqësore, por në atë marrëveshje nuk përfshihet siguri nga zjarri, breshëri dhe vërshimet.

TAHIRI: NUK SIGUROHEN KULTURAT BUJQËSORË NGA BRESHËRI, ZJARRI DHE VËRSHIMET

“Formë tjetër për t'i kompensuar bujqit është siguri. Ekziston njëfarë marrëveshje me Qeverinë, me disa banka..... Mirëpo, kam disa të dhëna që nuk sigurohen të gjitha kulturat dhe nuk sigurohen prej breshërit, prej zjarrit dhe prej vërshimeve”, tha ai. Ministri Mustafa ka thënë se nuk është i vetëdijshëm për një marrëveshje të tillë. “T’ju them të drejtën nuk jam i informuar për një marrëveshje të tillë”, thotë ai. Përndryshe, një pjesë e madhe e bujqve në të gjithë Kosovën janë dëmtuar si shkak i reshjeve të fundit të shiut.




“NE SI MINISTRI E BUJQËSISË E KEMI PJESË TË PROGRAMIT QEVERISËS 2020-2023 TA THEMELOJMË NJË FOND PËR SIGURIMIN E KULTURAVE BUJQËSORE, JEMI DUKE PUNUAR INTENSIVISHT DREJT KËTIJ FONDI. MINISTRIA E BUJQËSISË DERI MË TANI NUK KA PASUR FOND TË TILLË. AKTUALISHT JEMI DUKE PUNUAR EDHE ME DONATORË, NË ASPEKTIN LIGJOR DHE NË ATË FINANCIAR TË NDËRTOJMË NJË FOND TË VETËQËNDRUESHËM, I CILI UA NDIHMONT FERMERËVE KOSOVARË QË TË REALIZOJNË SIGURIMET BUJQËSORË”, KA THËNË MINISTRI I BUJQËSISË BESIAN MUSTAFA.

Shoqata e Sigurimeve dhuron 15 mijë maska dhe mbi 3 mijë e 300 dezinfektues për gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë

15,000 maska, 3000 dezinfektues 100 mililitërsh si dhe 300 dezinfektues nga një litër i ka dhuruar Shoqata e Sigurimeve të Kosovës për gazetarët e të gjitha medieve që operojnë në vendin tonë

ISIGURIME

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), së bashku me Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës (ShSK), kanë nënshkruar kontratë bashkëpunimi, me qëllim që t'u ndihmohet gazetarëve në Prishtinë. Kjo është bërë e mundur duke e pasur parasysh se që nga fillimi i pandemisë, Komuna e Prishtinës është ballafaquar me numrin më të lartë të rasteve me të infektuar me Covid 19. Në donacionin e siguruar nga ShSK-ja, bëjnë pjesë 15 mijë maska, 3 mijë dezinfektues 100ml dhe 300 dezinfektues nga 1 litër. Kryetarja e AGK-së, Gentiana Begolli Pustina, e vlerësoi të një rëndësie të veçantë këtë ndihmë të ShSK-së, për t'i mbrojtur gazetarët, të cilët edhe ashtu ballafaqohen me probleme të shumta, jo vetëm financiare. Sipas saj, mbrojtja e gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve, kontribuon jo vetëm në mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe funksionimin e medias, por edhe në informimin e saktë dhe në kohë reale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ndërsa, drejtori i ShSK-së, Sami Mazreku, u shpreh i përkushtuar të thellojë bashkëpunimin me AGK-në, me ç'rast theksoi gatishmërinë që AGK së bashku me



ShSK-në të organizojnë trajnime vjetore për gazetarët që raportojnë për ekonomi dhe po ashtu t'i shpërblejnë gazetarët për çdo vit me tri çmimet për storiet më të mira. Sa i përket procedurës së shpërndarjes, AGK posedon listat e kolegëve tanë që punojnë në terren dhe të cilët janë furnizuar me pako mbrojtëse gjatë

donacionit të parë. Për tërheqjen e pakove të reja, të njëjtët do të njoftohen me kohë. AGK do ta vazhdojë angazhimin drejt sigurimit të donacioneve tjera, në mënyrë që të ndihmohet komuniteti që përfaqësojmë dhe kolegëve tanë t'u lehtësohet sadopak puna përgjatë pandemisë.

Humbje milionëshe nga veturat e paregjistruara

Pandemia Covid-19, përveç sektorit të shëndetësisë dhe ekonomisë, ka goditur edhe sektorin e sigurimeve. 52 mijë veturave u ka skaduar regjistrimi gjatë muajit prill dhe maj dhe të njëjtat për shkak të pandemisë nuk kanë pasur mundësi që ta vazhdojnë atë. Ndërsa para pandemisë, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Kosovë kanë qenë të paregjistruara 148 mijë vetura. Kështu ka deklaruar në një intervistë për Front Online, drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku. “Deri në fillim të pandemisë sipas të dhënave zyrtare të MPB-së kanë qenë 148 mijë automjete të paregjistruara. Sigurisht, me mbylljen e Qendrave të Regjistrimit gjatë kohës së pandemisë është rritur ky numër sepse qytetarët nuk kanë pasur mundësi që t'i vazhdojnë regjistrimet e tyre. Sipas informatave që ne kemi, vetëm në muajin mars dhe prill janë 52 mijë automjete që e kanë pasur kohën ta vazhdojnë regjistrimin, dhe një gjë të tillë kanë vazhduar që ta bëjnë nga data 18 maj e tutje, në kohën kur edhe MPB-ja e ka bërë hapjen e Qendrave të Regjistrimit”, ka thënë ai.

5 MILIONË EURO HUMBJE DITORE PËR SHETIN NGA VETURAT E PAREGJISTRUARA

Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK), kanë marrë iniciativë për tra-

jtimit e automjeteve të paregjistruara në në vendin tonë. Sipas Mazreku, ky vendim do të rregulloj shumë probleme. “Beso që shumë shpejt do të formohet edhe grupi punues ku do t'i dërgojmë të gjitha format e mundshme ligjore, ndryshimet e mundshme që duhet t'i marrë secili akter që më në fund ky proces të mbyllet sa më mirë, sa më lehtë dhe sa më shpejt”, ka deklaruar ai. “Nëse e marrim numrin total është një humbje shumë e madhe, mirëpo nëse e marrim një numër më të vogël që ne e vlerësojmë në raport me dëmet që shkaktohen, atëherë humbja ditore si për shtetin ashtu edhe për industrinë e sigurimeve është rreth 5 milionë euro për neve dhe 5 milionë euro për shtetin”, ka thënë ai për Front Online.

GJOBAT PËR VETURAT E PAREGJISTRUARA 150 EURO, ATO PËR MUNGESË TË SIGURIMIT 200 EURO

Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, në një intervistë për Front Online ka thënë se gjobat që shqiptohen nga Policia e Kosovës për veturat e paregjistruara nuk kanë efekt. “Sipas të dhënave të Policisë dhe në bazë të Ligjit, gjoba për mosregjistrim është 150 euro, mirëpo ajo që nuk është e rregulluar është se çfarë ndodh me veturat të cilat gjobiten. Kemi raste kur policia e ka shqiptuar një gjobë dhe

pas gjobës ai automjet ka shkakuar aksident”, ka thënë ai. Ndërsa për sa u përket shqiptimit të gjobës për veturat që nuk kanë sigurim, Mazreku për Front Online ka thënë se pavarësisht që vlera e saj është 200 euro, një gjobë e tillë qysh nga viti 2011 nuk është shqiptuar asnjëherë. “Gjopa për mossigurim është 200 euro mirëpo kjo gjobë që nga viti 2011 nuk është shqiptuar asnjëherë sepse nuk ka qenë e specifikuar mënyra e kësaj procedure se si të lëshohet gjoba dhe se ku duhet të shkojnë ato automjete. Kështu, PK-ja e ka shqiptuar vetëm një gjobë, atë 150 euro”, ka thënë Mazreku. Mazreku ka folur edhe për kushtet që duhet të plotësojë Kosova për anëtarësim në Kartonin e Gjellbër. Ai ka treguar se përveç problemeve politike duhet të ulet edhe numri i automjeteve të pa regjistruara. “Ekziston edhe kushti që nuk mund të jetë më i madh se 5 për qind numri i automjeteve të paregjistruara. Aktualisht me këtë numër në Kosovë janë mbi 35% të automjeteve të paregjistruara dhe me këtë numër sigurisht që ne në çfarëdo aplikimi që e bëjmë në organizata jashtë Kosovës është joserioz, prandaj kam kërkuar edhe më herët por edhe sot që secili ta bëjë punën e vet dhe që në një kohë sa më të shkurtër edhe Byroja Kosovare e Sigurimit të bëhet gati për procedura të mëtutjeshme”, ka thënë ai për Front Online.